

VENDIM
Nr. 14, datë 9.1.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 55, DATË 6.2.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR AUTORIZIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE, QË OFROJNË NDIHMË JURIDIKE PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHTETI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 15, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 55, datë 6.2.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”, bëhen këto ndryshime dhe shitesa:

1. Pikat 5 dhe 6 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“5. Organizatat jofitimprurëse, që kërkojnë pajisjen me autorizim nga ministri i Drejtësisë, paraqesin aplikimin *on-line* për autorizim, si dhe dokumentacionin shoqërues, si më poshtë vijon:

a) Dokumentacionin që provon përvojë në ofrimin e ndihmës juridike parësore, të paktën në 3 (tri) vjet të veprimtarisë së tyre, duke përfshirë:

i. listën e rasteve të trajtuara ose projekteve të ndihmës juridike parësore të zhvilluara nga organizata gjatë 3 (tri) vjetëve, si dhe të dhëna statistikore për përfituesit e ndihmës parësore nga projektet e ndihmës juridike parësore;

ii. raportet përfundimtare për secilin rast ose raportet vjetore për projektet e listuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore, si dhe pasqyrat financiare për to;

iii. buxhetin total të secilit projekt, donatorët përkatës, si dhe listën e ekspertëve të brendshëm e të jashtëm, të përfshirë në këto projekte;

iv. në rast se organizata jofitimprurëse nuk ka zbatuar një projekt të posaçëm për ofrimin e ndihmës juridike parësore, por ky aktivitet është një komponent i një projekti tjetër, paraqiten dokumentet sipas nënndarjeve “i” deri në “iii”, të kësaj shkronje, vetëm për këtë komponent që lidhet me ofrimin e ndihmës juridike parësore.

b) Formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të anëtarëve të organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv.

6. Aplikimi *on-line* për autorizim dhe dokumentacioni i përcaktuar në pikën 5, të këtij vendimi, dorëzohet elektronikisht përmes portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, në adresë të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Për shqyrtimin e përmbushjes së kriterëve ligjore, nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, organet publike plotësojnë dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) vendimin e gjykatës për regjistrimin e organizatës jofitimprurëse;

b) kopjen e statutit të organizatës jofitimprurëse, ku specifikohet si pjesë e veprimtarisë ofrimi i ndihmës juridike, të depozituar në gjykatë;

c) vërtetimin nga organet tatimore se organizata jofitimprurëse i ka përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet;

ç) vërtetim nga gjykata se organizata jofitimprurëse nuk është në procedurë falimenti dhe/ose likuidimi;

d) vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv të organizatës jofitimprurëse nuk janë në proces hetimi apo gjykimi për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike;

dh) certifikatën e gjendjes gjyqësore të anëtarëve të organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv.”.

2. Në fjalinë e parë, të pikës 10, fjalët “... verifikon dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesit për marrjen e autorizimit ...” zëvendësohen me “... shqyrton aplikimin, verifikon dokumentacionin e administruar ...”.

3. Në fund të pikës 11 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Kundër urdhrit të ministrit për refuzimin e aplikimit për autorizim mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente.”.

4. Pikat 12 dhe 13 shfuqizohen.

5. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“14. Autorizimi i ministrit të Drejtësisë jepet pa afat. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas verifikon çdo 2 (dy) vjet përmbushjen e kriterëve ligjore nga organizatat jofitimprurëse. Organizatat jofitimprurëse, që janë autorizuar nga ministri i Drejtësisë, njoftojnë Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas për çdo ndryshim që lidhet me plotësimin e kriterëve ligjore për dhënien e autorizimit, brenda 3 (tri) ditëve nga data e kryerjes së ndryshimit.”.

6. Në pikën 16 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në fjalinë e parë, fjalët “... mund të revokojë ...” zëvendësohen me “... ose kryesisht, mund të shfuqizojë ...”;

b) Pas shkronjës “a” shtohet shkronja “a/1”, me këtë përmbajtje:

“a/1) mospërmbushjen e kriterëve ligjore.”.

c) Në shkronjën “ç”, fjala “... nuk ...” hiqet.

7. Në pikën 17, fjalët “... Revokimi i autorizimit i njoftohet organizatës jofitimprurëse ...” zëvendësohen me “... Shfuqizimi i autorizimit i njoftohet organizatës jofitimprurëse nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, te seksioni “Dokumentet e mia”, me vulë elektronike ...”.

8. Në pikën 18 fjala “... revokimin ...” zëvendësohet me “... shfuqizimin ...”.

II. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas verifikon përmbushjen e kriterëve ligjore nga organizatat jofitimprurëse, të autorizuar nga ministri i Drejtësisë, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Pas verifikimit, ministri i Drejtësisë urdhëron:

a) kryerjen e ndryshimeve përkatëse, me qëllim që vlefshmëria e autorizimit të jetë pa afat; ose

b) shfuqizimin e autorizimit, nëse vërtetohet mospërmbushja e kriterëve ligjore.

III. Detyrimi për të paraqitur aplikimin *on-line* për autorizim dhe dokumentacionin shoqërues, elektronikisht përmes portalit unik qeveritar “e-Albania”, si dhe detyrimi për të njoftuar shfuqizimin e autorizimit, të vulosur elektronikisht, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, hyn në fuqi pas ngritjes së sistemit të menaxhimit të çështjeve (CMS) dhe platformës *on-line* (OP) për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas. Deri në ngritjen dhe funksionimin e plotë të sistemit, aplikimi për pajisjen me autorizim paraqitet pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, ndërsa tërheqja e autorizimit bëhet pranë Ministrisë së Drejtësisë.

IV. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

